

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

ROLI I NDËRMJETËSVE NË SIGURIME SI KONTAKTI I PARË ME
KONSUMATORËT, KËRKESAT DHE KODI I SJELLJES

MSc. Ina SHEHU¹
Joana Skënderas²

Abstrakti

Tregu i sigurimeve është një treg i ri në Shqipëri dhe si i tillë ai është i panjohur nga një masë e gjerë e popullsisë. Në këtë mënyrë shoqërizimi dhe njohja e këtij tregu nga konsumatori duhet të bëhet me mënyra eficiente dhe me metoda të cilat kërkojnë njohjen nga afër të paketave të ndryshme që ofrohen nga shoqëritë e sigurimeve. Konsumatori është bërë mjaftueshëm selektiv dhe shpesh edhe mospërfillës ndaj gamës së gjerë të informacionit që i ofrohet në përditshmëri. Për këtë arsye, prezantimi nga afër i produkteve është një mënyrë e mirë për përthithjen dhe qëndrimin gjatë në kujtesën e konsumatorit.

Qëllimi i këtij punimi është të theksojë jo vetëm rolin e ndërmjetësuesit në sigurime si kontakti i parë me konsumatorin, por edhe mënyrat, kërkesat e kodin e sjelljes. Një ndërmjetësues jep një ndikim fillestar pozitiv, sepse ai ofrohet të japë informacion në një mënyrë mjaft miqësore dhe me përkushtim për atë që prezanton, por kjo lidhet kryesisht me kodin e sjelljes dhe aftësitë profesionale që zotëron.

Ky punim bazohet në një sondazh, i cili do të tregojë ndërthurjen e sjelljeve dhe dëshirave të konsumatorëve për marrjen, asimilimin e informacioneve dhe zbatimin e tyre.

Fjalët kyçe: ndërmjetësuesi, konsumatori, shpërndarja.

¹ Lecturer “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business, Durrës, Albania e-mail: inashehu@hotmail.it

² Student in Master of Science, “Aleksandër Moisiu” University, Faculty of Business. joanaskenderas95@gmail.com